

Poezia shqipe me komunikativitet të ulët

Rezyme

Poezia shqipe ka ecur duke u zhvilluar e transformuar në periudha e rryma letrare, prej filobiblikes e deri te modernia e përtej saj. Secila prej tyre barti me vete karakteristika e elementë dallues e kodifikues që lanë shenja e vlera të çmuara letrare. Periudhat e mëvonshme, kryesisht shek. XX, na vjen me llojlojshmëri rrymash avangarde e trendesh letrare si shprehje të modernitetit me shpërthimet e larmishme, me ndikimet nga letërsitë moderne evropiane e botërore dhe me shijen e fortë autoktone, të rritur brenda stuhive e rrebesheve historike, politike e kulturore shqiptare. I kemi parasysh rrymat letrare avangarde që janë shfaqur para dhe pas Luftës së Parë Botërore si: Futurizmi (në Itali dhe Rusi), Ekspresionizmi (në Gjermani dhe në Austri) Dadaizmi (në Zvicër), Surrealizmi (në Francë) dhe Letërsia sociale (në Rusi dhe në shtetet e Evropës së mesme). Pastaj brenda tyre e më tej shohim modernen e postmodernen me rryma të fuqishme si: neoromantizmi, simbolizmi e surrealizmi, parnasizmi (me poezinë absolute) dhe të gjitha bashkë tek lidhen me hermetizmin si rrjedhojë e rrethanave shoqërore e politike në hapësirat dhe kontekstet e ndryshme gjeo-historike e socio-kulturore. Kjo e fundit është sfera e interesimeve të mia në punën time shkencore, prandaj do të shohim tutje këtë perspektivë brenda poezisë sonë të bukur shqipe, asaj që ka komunikim të ulët.

” Letërsia shqipe e shek XX është zhvilluar ndërmjet dy ideologjive të mëdha kolektiviste: nacionalizmit dhe komunizmit.”¹ Rrjedhimisht takohen letërsitë, si ajo me vlerë dhe ajo me funksion moral e politik (dallimin e të cilave e theksojnë me rend studiuesit që nga Konica), të cilat kanalizohen në kanone letrare të modernizmit dhe sorealizmit, siç i quan Sabri Hamiti. Këto të dyja përplasen aq shumë në mes vete sa edhe nisin përjashtime, anatemime të autorëve eminentë që nuk i bindeshin normës, metodës krijuese që tashmë ishte bërë institucionale dhe

¹ Sabri Hamiti, Studimet letrare, ASHAK, Prishtinë, 2003, faqe 726.

shtetërore, në funksion të drejtpërdrej politik, ideologjik. Letërsia moderne, në këtë rast poezia moderne, vjen me individualite të shquara letrare që lanë gjurmë me kryeveprat e tyre. ” E shfaqur qoftë si trashëgimi e simbolizmit (Asdreni Lasgushi), qoftë si realizëm me frymë kritike (Çajupi, Noli), qoftë në trajtë neoklasiciste (Fishta, Mjeda, Haxhiademi) apo në trajta të papara të modernitetit në prozë te ne (Koliqi, Migjeni, Kuteli), letërsia e hershme moderne shqipe që zotëron gjysmën e parë të shekullit 20 ka dy karakteristika themelore: krijimin e trajtave e të strukturave të reja letrare dhe krijimin e vetëdijes (ndërgjegjes) letrare që letërsia është krijim i veçantë estetik pa marrë parasysh qëllimet.”² Ndërkaq nga gjysma e dytë e shek XX vjen në shprehje letërsia që ballafaqohet ngusht me ideologjinë komuniste në gjithë hapësirën shqiptare, në Shqipëri e Kosovë, duke iu nënshtruar regjimeve diktatoriale shumë të ashpra. Shumë autorë u trajtuan fare pak (edhe atë duke u keqinterpretuar e shtrembëruar vlera e veprave të tyre) ose u lagruan fare nga sistemi letrar dhe ai shkollor, nga antologjitë e historitë letrare, të cilat kishin zgjedhje dhe interpretime sipas preferencave ideologjike të kohës. I kemi gjithnjë parasysh shkrimet dhe interpretimet e vonshme mbi krijimtarinë e autorëve të anatemuar (Fishta, Konica, Kuteli, Prenushi, Vangjel Koça, Branko Merxhani, Anton Harapi, Bernardin Palaj, etj.), ndërkaq e dimë gjithashtu se si hoqën a po si mbijetuan autorët modernë bashkëkohorë të viteve 60-70 (Martin Camaj, Teki Dërvishi, Fatos Arapi, Beqir Musliu, Zef Zorba, Xhevahiq Spahiu, Frederik Rreshpja, Moikom Zeqo, etj.) e këndeje, të cilët duke dashur t`u shmangen regjimeve kanë bërë kompromis me gjuhën poetike, duke i hyrë ”aventurës semiologjike” (nocion i Bartit). Shumica zgjodhën modelin e poezisë me komunikim të ulët, por me figurshmëri të lartë, vështirë të receptueshme, prandaj na interesojnë shenjat dhe të shenjuarit brenda teksteve të tyre. Në këtë vijë Kujtim. M. Shala thekson se:” Tekstet moderne sprovajnë lexuesin paprerë... Tekstet moderne janë projekte semiotike dhe duam lexim semiotik. Autorët modernë hapen vetëm përpara lexuesve që u ngjajnë dhe bëhen mal i egër për ata që s`u ngjajnë”³.

Kur themi poezi me komunikimit të ulët, nënkuptojmë poezinë që rri pranë ose brenda poezisë hermetike. Vetë fakti që ajo nuk receptohet lehtë nga lexuesit, d.m.th. mban në vete diçka që nuk vërehet lehtë, diçka që fshihet, apo diçka që ruhet thellë në brendinë e mesazhit apo të mendimit artistik të autorit. Duhet zbërthyer koncepte e nocione që lidhen me

²Sabri Hamiti, Letërsia moderne, Vepra letrare, Faik Konica, Prishtinë, 2002, f.10.

³ Kujtim M. Shala, Letërsia shqipe në katër pamje, Buzuku, 2007, faqe 69.

hermetizmin, për të pretenduar ta kuptojmë idenë e autorëve që me artin e tyre e përfaquan këtë rrymë.

Nëse nisemi nga shpjegimet e konceptit të hermetizmit nga Clarence Hugh Holman, William Harmon, Hermeticizmi është ” Pjesë e doktrinës mistike dhe okulte, që prek alkiminë dhe spirualizmin. Hermetizmi ka qenë i rëndësishëm për një numër artistësh modernë, interesimi i të cilëve tërhiqet nga shfaqja mekanike e botës së tanishme, shekullare dhe reale”⁴, i bie që autorët nuk e thonë troç atë që e shohin dhe e ndjejnë në realitetin e tyre, por bëjnë një shmangie nga mesazhi i drejtpërdrejtë, por si dhe pse? Pastaj nëse shikojmë si lindi hermetizmi (në Itali), ajo rrymë vjen si shprehje kundëstuese ndaj shoqërisë, pushtetit të kohës, por me një gjuhë novatore në artikulumin e vargut, me shprehjen e thukët, me mendimin e thellë, me pak fjalë por me gjuhë shumë të figurshme e tejet personale, goxha të mbyllur si mesazh dhe me shumësi kuptimi e interpretimi. Kështu vijnë autorët reprezentativë dhe përfaqësues të kësaj rryme (Carlo Bo (1911-2001), Mario Luzi (1914-2005), Alfonso Gatto (1909-1976), Salvatore Quasimodo (1901-1968), Giuseppe Ungaretti, etj.) të cilët u parapëlqyen dhe u bënë model edhe për autorët tanë që kishin kulturë dhe formim letrar me diapazon tejhapësinor e kulturor.

Siç thotë studiuesi ynë Neka Ndoja, ” Poezia hermetike merr jetë së shumti nga leximet dhe interpretimet e tyre, pasi ajo nuk i drejtohet drejtpërdrejt të shenjuarve. Të shenjuarit e poezisë hermetike zbulohet nga interpretimet e tyre dhe në mistikën e stërhollimit të dhënies së mesazhit. Nga kjo rrymë poetike shkrimtarët tanë morën elementin e fshehtësisë së përcjelljes së mesazhit, nuk morën aq intertekstet sesa manierën e rrugëtimit të shenjuesit për t’u kthyer në të shenjuarin që bart strategjia e tekstit poetik”⁵

Brenda këtij punimi kam trajtuar me rend autorët e caktuar (Fahredin Gunga, S. Hamiti, N. Halimi, Rr. Dedaj, B. Musliu, Z. Zorba), duke e interpretuar poezinë e tyre të krijuar në vitet 60-80-ta, shikuar nga shumë dimensione, si nga rrafshi ideo-tematik, strukturor, fenomenologjik, me gjithë elementet stilistike e figurative deri te ato metrike.

⁴A handbook to Literature”, C. Hugh Holman, William Harmon; Macmillan, 1986, f. 234.

⁵ Leka Ndoja, Hermetizmi në letërsinë shqipe, Pakti, 2012, faqe 5.

ALBANIAN POETRY OF LOW COMMUNICATION

Resume

Albanian poetry has been evolving and transforming into periods of literary currents, from Philobiblic to Modernity and beyond, and each of them brought characteristics with distinctive and codifying elements that left marks and precious literary values. Subsequent periods, mostly the 20th century, came with a variety of avant-garde streams of literary trends as an expression of modernity with varied explosions, with influences from modern European and world literature, but with the strong taste of dough made by autochthonous seeds, grown in storms and historical, political storms of Albanian culture. It is consider that the avant-garde literary currents that appeared before and after World War I: Futurism (in Italy and Russia), Expressionism (in Germany and Austria) Dadaism (in Switzerland), Surrealism (in France) and Social literature in Russia and in the countries of Central Europe). Then, within them, we have the modern and the postmodern with powerful currents such as: Neo-romance, Symbolism and Surrealism, Parnasism (with absolute poetry) and all linked to Hermeticism as a result of social and political circumstances in different geo-contexts and historical and socio-cultural contexts. The last one is the sphere of interest in scientific work, so is with inters to look beyond this perspective within Albanian poetry, which has low communication.

"Albanian literature of the twentieth century has developed between two great collectivist ideologies: nationalism and communism."⁶ Consequently, literatures meet, as it is of value, and they do so with a moral and political function (whose distinction is emphasized by the scholars since Konica), channeled as Sabri Hamiti calls the literary canons of Modernity and Socrealism. Both of them collide so much between themselves that they begin with the exceptions, anathema,

⁶Sabri Hamiti, Studimet letrare, ASHAK, Prishtinë, 2003, f. 726.

of the notorious authors who did not obey the norm, the creative method that had already become institutional and state, in direct political and ideological function. Modern literature, in this case modern poetry, comes with prominent literary individualities that left traces of their masterpieces. "Displayed either as a legacy of symbolism (Asdreni, Lasgushi) or as a realism with critical spirit (Çajupi, Noli) or in neoclassical form (Fishta, Mjeda, Haxhiademi) or in the uncharacteristic shapes of modernity in prose (Koliqi, Migjeni, Kuteli), the early modern Albanian literature that possesses the first half of the 20th century has two fundamental features: the creation of new literary structures and structures and the creation of literary consciousness that literature is a special aesthetic creation regardless of intentions. "⁷Meanwhile, from the second half of the 20th century came a literature that is closely confronted with the communist ideology throughout the Albanian space, in Albania and Kosovo, undergoing very harsh dictatorial regimes. Many authors were treated very little (even misinterpreted and distorted the value of their works, for example: Konica, Fishta, Kuteli etc.) or were removed completely from the literary and the school system, from anthologies and literary stories, which made choices and interpretations according to ideological preferences of the time. For instance are the late writings and interpretations of the anathema authors (Fishta, Konica, Kuteli, Prenushi, Vangjel Koça, Branko Merxhani, Anton Harapi, Bernardin Palaj, etc.), and we also know how they suffered or how they survived modern contemporary authors of the 60's and 70's (Martin Camaj, Teki Dervishi, Fatos Arapi, Beqir Musliu, Zef Zorba, Xhevahiq Spahiu, Frederik Rreshpja, Moikom Zeqo, etc.) and who, wanting to avoid regimes, compromise with the poetic language, entering "semiological adventure" (Bart's notion)⁸. Most chose the low-level poetry model, but with a high figure, difficult to decode, so we are interested in the signs and markings within their texts. "Modern texts try out unconditional reader ... Modern textbooks are semiotic projects and we want semiotic reading. Modern authors are only open to readers who resemble and become wild mountain for those who do not resemble it. "⁹

When we say low-level poetry, we mean poetry that is beside or within hermetic poetry. The fact that it is not easily understood by readers because it keeps something that is not easy to notice, something that is hidden, or something that is deeply rooted in the author's message or

⁷Sabri Hamiti, *Letërsia moderne, Vepra letrare*, Faik Konica, Prishtinë, 2002, f.10.

⁸ The notion addressed by Roland Bart in his book: *Semiological Adventure*, translated by Renaissance, Pristina, 1987.

⁹Kujtim M. Shala, *Letërsia shqipe në katër pamje*, Buzuku, 2007, f. 69.

artistic thought. It is necessary to break down concepts and notions related to Hermetism, to try to understand the idea of the authors who, with their art, embraced this stream.

If we start from the explanations of the Hermetism concept by Clarence Hugh Holman and William Harmon, Hermeticism is "a part of the mystical and occult doctrine touching alchemy and spirituality. Hermeticism has been important to a number of modern artists whose interest is drawn from the mechanical manifestation of the current, secular and real world."¹⁰ The authors do not state what they see and feel about their reality, instead they do a deviation from direct message, but how and why? It is seen that Hermetism was born as a contradictory expression of society, the power of time, an innovative language in the articulation of the verse, the expressive expression, profound thought, in a few words, but with very figurative language very personal, pretty closed as a message, but with a multitude of meaning and interpretation. So come the representative and representative representatives of this stream (Carlo Bo (1911-2001), Mario Luzi (1914-2005), Alfonso Gatto (1909-1976), Salvatore Quasimodo (1901-1968), Giuseppe Ungaretti, etc.) they became a model for our authors who had a culture and literary formation with a wide range of cultural and cultural backgrounds.

As Neka Ndoja says, "Hermetic poetry takes the most of their readings and interpretations, as it does not address the markers directly, the hermetic poetry is revealed by their interpretations and the mysticism of the message's eloquence. From this poetic stream, our writers took the element of the secret of the message's transmission, did not get so much intertextures as the roadmap of the marker to return to the mark of the poetic text strategy."¹¹

Within this paper I have dealt with the order of certain authors (Fahredin Gunga, S. Hamiti, N. Halimi, Rr. Dedaj, B. Musliu, Z. Zorba), addressing their poetry created in the 60s and 80s, viewed from many dimensions, from a thematic-themed plan, fenomenologic plan, the structure, with all stylistic and figurative elements to metric ones.

¹⁰A handbook to Literature", C. Hugh Holman, William Harmon; Macmillan, 1986, f. 234.

¹¹LekaNdoja, Hermetizmi në letërsinë shqipe, Pakti, 2012, f. 5.